



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 06 prill 2020**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1241\_2020**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084),
- Nenin 16 paragrafin 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja, e miratuar me dt. 11.11.2014 nga Bordi i ZRRE-së,
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V\_923\_2018 të datës 29 mars 2018 për shoqërinë NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Dragash, ZK Dragash, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, komuna e Dragashit,
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V\_923\_2018 të datës 29 mars 2018 për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Dragash, ZK Dragash, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, komuna e Dragashit, të datës 03.03.2020 nr. prot. 122/20 të shoqërisë NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., me adresë: rruga "Jonit", nr. 92/2, Prizren, Republika e Kosovës, dhe

**në seancën e mbajtur me datë 06 prill 2020 nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V\_923\_2018 të datës 29 mars 2018 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Dragash, ZK Radesh, Plavë dhe Rapçe, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, komuna e Dragashit, edhe për një (1) vit.

**A r s y e t i m**

- o ZRRE me datë 21.12.2015 nga shoqëria NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Hidrocentrali HC Dragash, ZK Radesh, Plavë dhe Rapçe, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, komuna e Dragashit, Republika e Kosovës.
- o Bordi i ZRRE-së, pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 23 shkurt 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar Nr. V\_788\_2016 dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.



- ZRRE me datë 19.07.2017 nga shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Dragash, ZK Radesh, Plavë dhe Rapçe, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, komuna e Dragashit, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore dhe ujore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga komuna dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i ZRRE me datë 29 mars 2018 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V\_923\_2018 shoqërisë NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Dragash, ZK Radesh, Plavë dhe Rapçe, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, komuna e Dragashit.
- ZRRE me datë, 03.03.2020 nga shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimin për Autorizimin FINAL V\_923\_2018 të datës 29 mars 2018, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC HC Dragash, ZK Radesh, Plavë dhe Rapçe, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 29 mars 2021 për finalizimin e projektit.
- Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., në kërkesën e saj ka theksuar se: janë në fazën përfundimtare të investimit të projektit HC Dragash. Vepra e marrjes, Dekantuesi janë ndërtuar dhe të përfunduara, ndërsa Tubacioni dhe shtëpia e Centralit (Objekti i Makinerisë), janë në fazën e ndërtimit pra, në aspektin fizik projekti është në përfundim e sipër.
- Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., poashtu ka sqaruar se kanë përfunduar, shtrirjen e largpërçuesit dhe janë shtrirë kabllo të largpërçuesit për katër km gjatësi, pusetat janë të përfunduara dhe të ndërtuara sipas specifikacionit të kërkuar nga ana e KEDS. Linja është përfunduar sipas pëlqimit elektroenergjetik dhe kanë bërë edhe pranimin teknik të largpërçuesit për projektin HC Orqusha në operim, ku në largpërçuesin e nyjet do të lidhet edhe projekti HC Dragash.
- Andaj, bazuar në të gjitha ato që u paraqitën më lartë, shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që t’iu lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V\_923\_2018 të datës 29 mars 2018, për finalizimin e këtij hidrocentrali edhe për një afat kohorë një (1) vjeçar.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Dragash, ZK Radesh, Plavë dhe Rapçe, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, komuna e Dragashit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se arsyeshmëria e kërkesës së aplikuesit është e bazuar, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ku janë prezantuar fakte se brenda kësaj periudhe do të finalizohet projekti, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së



Autorizimit Final V\_923\_2018 i datës 29 mars 2018, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.

- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V\_923\_2018 i datës 29 mars 2018, do të vlen deri me datë **29 mars 2021**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, dhe në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rusliu, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Dragashit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MIA-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.